

7.2 HAPJA DHE MBYLLJA E FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE

Kur regjistrimi ngarkohet në redaktues, të gjitha fushat janë në formatin e përmbledhur.

Nëse dëshironi të hapni fushën dhe të shfaqni përmbajtjen e saj (nënfushat dhe treguesit përkatës), klikoni shenjën grafike ► para fushës. Nëse dëshironi ta mbyllni fushën dhe të fshehni përmbajtjen e saj, klikoni shenjën grafike ▼.

Mundësitë...

Fushën e veçantë mund ta hapni apo mbyllni edhe duke klikuar dy herë mbi të, ose duke shtypur shigjetën <djathtas> apo <majtas> në tastaturë.

Nënfushën e veçantë në regjistrim e hapni duke përdorur një nga mënyrat në vazhdim:

- duke klikuar dy herë mbi nënfushë ose
- duke klikuar apo duke shtypur shigjetat në tastaturë për zgjidhni nënfushën dhe pastaj shtypni tastin <Enter> ose
- duke klikuar apo duke shtypur shigjetat në tastaturë për zgjidhni nënfushën dhe përdorni metodën **Redaktimi / Redakto** ose
- duke klikuar apo duke shtypur shigjetat në tastaturë për zgjidhni nënfushën dhe nga menuja e kontekstit përdorni metodën **Redakto**

Nënfushën mund ta mbyllni në mënyra të ndryshme:

- klikoni jashtë fushës për futjen e të dhënave ose
- shtypni tastin <Enter> ose
- për zgjidhni metodën **Redaktimi / Konfirmo të dhënat e shënuara** ose
- nga menuja e kontekstit për zgjidhni metodën **Konfirmo të dhënat e shënuara**

Të gjitha fushat mund t'i hapni dhe t'i mbyllni njëherësh (shih kap. 7.8).